

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU BERAT
BASHKIA DIMAL

PROJEKT
PËR PËRMIRËSIM KULLOTE

Fshati: "Bistrovicë"
Zona kadastrale: Nr.1200
Emri popullor i vendit: "Shullëri Gurajve"
Ekonomia Kullosore: "Mali Bardhë"
Ngastra/Nënngastra: Nr. 6/a


PUNOI: ENRI HËNA



KONFIRMOI: FATIME PLAKU



MIRATOI:
KRYETAR
JULIANA MEMAJ



KAPITULLI I

OBJEKTI QËLLIMI

- **Konsiderata të përgjithëshme**

Përmirësimi është **4.3 ha** dhe shtrihet në territorin e Njesisë Administrative Ura Vajgurore.

- **Qëllimi:**

Qëllimi i hartimit të projektit është : “Përmirësimi i gjëndjes aktuale të sipërfaqes kullimore nëpërmjet ndërhyrjeve me punime për pastimin nga shkurret e dëmshme, duke ndikuar në shtimin e kapacitetit kullor, përmirësimin e kushteve për mbarështrimin e qëndrueshëm të blegtorisë si dhe shtimin e produkteve blegtorale të fermerëve të zonës.

Me punimet e përmirësimit do të realizojmë instalimin e bimësisë barishtore në pjesët e sipërfaqes të mbuluara me gur e shkurre të dëmshme.

- **Objektivat:**

Nepërmjet ndërhyrjes me punime “Përmirësimi të kullotës” do të realizohet :

- a. Veshja e sipërfaqeve boshe me bimësi barishtore të vlefshme*
- b. Shtimin e kapacitetit kullor.*
- c. Frenimin e fenomenit të erozionit.*
- d. Shtimin e produkteve blegtorale*
- e. Përmirësimin e strukturës së bimësisë barishtore*
- f. Uljen e nivelit të papunësisë dhe përmirësimin e nivelit ekonomik të banorëve të zonës*
- g. Ndërgjegjësimin e komunitetit për menaxhimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e fondit kullor:*

KAPITULLI II

STUDIMI I OBJEKTIT

- **Vendosja gjeografike dhe administrative:**

Objekti : Nodohet në territorin e fshatit Bistrovicë në Njesisë Administrative Ura Vajgurore bën pjesë në ekonominë kullimore “Mali Bardhë”, zonën kadastrale 1200, parcela/nëparcela është 1 ,Nr. 6/a shtrihet në territorin e Njesisë Administrative Ura Vajgurore , Bashkia Dimal.

- **Kufijtë Natyral:**

Objekti Shullëri Gurajve parcela nr.6/a i planifikuar për ndërhyrje me punime përmirësimi kullote kufizohet:

Nga veriu: kufizohet me tokat bujqësore.

Nga jugu: kufizohet me rrugën e arave .

Nga lindja: kufizohet me rrugen auto rurale Skrevan- Bistrovicë.

Nga perëndimi: kufizohet me tokat bujqësore.

- **Sipërfaqja:**

Parcela/at/nënparcela/at nr. 6/a e ekonomisë kullimore Mali Bardhë ka një sipërfaqe prej 14.8 ha nga kjo, propozohet për ndërhyrje me punime përmirësuese sip. prej 4.3 ha, e cila shfrytëzohet për kullotje gjatë periudhës Prill-Shtator (6 muaj) nga barinjët e fshatrave Skrevan, Bistrovicë.

- **Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara:**

Objekti "Shullëri Gurajve" përshkohet nga rruga auto rurale Nëpërmjet kësaj rruge lidhen dhe fshatrat, Skrevan Bistrovicë me njësinë administrative Ura Vajgurore e bashkisë Dimal.

- **Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia:**

Janë shpate me pjerresi mesatare Shtrihet mbi formacion amnor flishe. ka disa lendina të vogla të pasura me bimësi barishtore.

- **Lartësia:**

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e objektit të planifikuar për ndërhyrje është 350 m, lartësia minimale 550 m, lartësia maksimale 500 m.

- **Rrjeti hidrografik:**

Objekti përshkohet nga përroska të rralla, të cilat mbajnë ujë vetëm gjatë periudhave me reshje. Në periudhën e thatë të verës këto përroska nuk mbajnë ujë.

- **Kushtet klimatike:**

Objekti përfshihet në zonën e klimës mesdhetare paramalore, nën zona veriore dhe lindore, e cila karakterizohet nga një dimër i gjatë, relativisht i ftohtë e vere të thatë, zonën Fitoklimatike Fagetum.

Temperatura mesatare vjetore varion nga 11.4 - 12.5° C. Temperaturat mesatare minimale të regjistruara varjojnë nga 0.5 - 3° C dhe që i përkasin muajve dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat mesatare maksimale varjojnë nga 21.3 - 21.5° C dhe i përkasin muajve Korrik-Gusht.

Minimumi absolut i temperaturës varion nga -5° deri -15° C, dhe në dimra të ftohtë ndodh të zbrese dhe më poshtë, dhe i përkasin periudhës Dhjetor-Shkurt. Maximumi absolut i temperaturave varion nga 30° C - 35° C. dhe i përket periudhës Korrik-Gusht. Periudha me ngrica është mesatare, vrojtohen rreth 30-40 dite në vit, gjatë të cilave temperatura minimale është ≤ 0° C.

Periudha e Vegjetacionit (temperatura mesatare > 10° C) fillon mesatarisht në 15 ditëshin e dytë të Marsit dhe vazhdon deri nga fundi i Tetorit.

Reshjet: Sasia mesatare vjetore e reshjeve varion nga 950-1060 mm/vit. Sasi më e madhe e reshjeve është rregjistruar gjatë periudhës së vjeshtës e dimrit. Sasi më e vogël e reshjeve është rregjistruar gjatë muajve Korrik-Gusht në sasi 45.5 - 52.6 mm.

Trashësia e dëborës arrin mesatarisht 10 - 20 cm, por në disa dimra të ashpër ka arritur deri në 100 cm.

Gjatë periudhës së vegetacionit reshjet variojnë nga 500 - 505 mm.

Temperaturat dhe reshjet kanë një rëndësi në zhvillimin e bimësisë barishtore. Reshjet gjatë periudhës së vegetacionit ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e shtresës barishtore si dhe zgjatjen e periudhës së shfrytëzimit për kullotje.

Temperaturat dhe reshjet mesatare mujore e vjetore.

St. Krumë	Muajt												Mes Vjet
	J	Sh	M	P	M	Q	K	G	Sh	T	N	Dh	
Temper. Mes.(°C)	0.5	3	6.2	10.8	15.4	19.1	21.3	21.5	17.4	12	7.2	2.7	11.4
Reshjet Mes. mm.	117.3	92.1	88.1	85.1	84.9	57.6	45.5	52.6	74.8	104	134	123	1059

• Toka:

Objekti "Shullëri Gurajve" përfshihet në tipin e tokave të murrme pyjore të cekëta, thellësia mesatare e saj arrin nga 20 – 40 cm; lagështia 18-20 %, reaksioni acid, lëgusha mungon. Toka është me strukturë rano-argjilore, tekstura kokrrizore, me gurë në 5 – 10, % të sipërfaqes.

Bimësia barishtore i mbron këto toka nga fenomeni i erozionit.

Përbërja e bimësisë:

Ngastra nr. 6/a është e veshur me bimësi barishtore të familjes graminace në 65 % të sipërfaqes, të familjes leguminoze (tërfil, thuepulë) në 30 % të sipërfaqes dhe të tjera në 5 % të sipërfaqes. Rreth 10 % e sipërfaqes është e veshur me shkurre të llojit, Fier, Xanë, Ferrë,

Shkurret e dëmshme si Fier, Ferrë dhe Xanë, dhe barerat e këqinj etj, të cilat duhet të priten e digjen, të sipërfaqes së propozuar për ndëryrje me punime përmisimi të sipërfaqes.

KAPITULLI III

TEKNIKA E KRYERJES SË PUNIMEVE

• PUNIMET QE DO TE KRYHEN:

Punimet e planifikuara (Pastrim shkurret dhe barishtet e dëmshme) ndikojnë në shtimin e sipërfaqes me bimësi barishtore. Spërfaqja e çliruar nga shkurret e dëmshme, në mënyrë natyrale ose me ndërhyrje përmirësuese vishet me bimësi barishtore të ngrëshme nga blegtoria, duke shtuar rendimentin dhe kapacitetin kullor të kullotës. Gjithashtu eliminon dëmtimet mekanike dhe infeksionet që mund tu shaktohen kafshëve gjatë kullotjes.

Pastrim nga shkurret e dëmshme: Gjatë kryerjes së punimeve do të priten vetëm shkurret e dëmshme (drizat, ferrat, bezge etj), ndërsa shkurret e tjera si dëllinjat, dushqet, frashëri, bushi, etj,

të mos priten pasi ato shfrytëzohen për hijezim dhe për kullotje nga ana e blegtorisë. Prerja të bëhet gjatë periudhës së vegetacionit në mënyrë që të minimizohet llastarimi e rigjenerimi i tyre. Prerja kryhet me vegla të thjeshta pune si sopata, kmesa (kosore), etj. Mbeurinat që rezultojnë nga prerja e shkurreve të dëmshme, grumbullohen në vënde inproduktive e digjen. Gjatë djegies, duhet të merren masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri, në mënyrë që ai të mos përhapet e rrezikojë djegien e sipërfaqes kullimore.

KAPITULLI IV

• Grafiku i punimeve:

Partneret kryesore për zbatimin e projektit janë komuniteti i fshatrave , Skrevan e Bistrovicë struktura e administrim menaxhimit të pyjeve pranë bashkisë Dimal, Njesia Administrative Ura Vajgurore, Subjekti private (Sipas njoftimit kontrates) mund te kryhen punime e parashikuara do sigurojë fuqin punëtore të nevojshme për realizimin e punimeve, në bashkëpunim me drejtuesin teknik të punimeve do bëhet trajnimi i punëtorëve për mënyrën e kryerjes së proceseve të punës sipas planifikimit. Ritmiksht gjatë kryerjes së punimeve nga ana e strafit drejtues të subjekti privat e drejtuesi teknik i punimeve, do të organizohen kontrolle për cilësinë e kryerjes së punimeve, në rast konstatimi të metash, lihen detyra për përmirësim.

Punimet për grumbullimin e gurëve, fillojnë mbas lidhjes së kontratës e trajnimit të punëtorëve. Mund të punohet gjatë gjithë vitit, me përjashtim të ditëve me reshje, ndërsa prerja dhe djegia e shkurreve të dëmshme, ne çdo kohë te vitit.

• Efektiviteti i ndërhyrjes:

Gjithashtu fermerët e fshatrave Skrevan dhe Bistrovicë do përfitojnë në mënyrë indirekte pasi do rritet numri i krerëve të bagëtive që mbarështrojnë si dhe rendimenti/krerë, duke shtuar prodhimet blegtorale për konsum dhe për treg, që do ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe zhvillimin e agroturizmit.

Mbrojtjen e objektit nga fenomeni i erozionit, etj

Fuqia punëtore e nevojshme për realizimin e punimeve ka mundësi të sigurohet nga fshatrat në afërsi të objektit, pasi në këto fshatra dhe niveli i papunësisë është i lartë. Punëtorët do përfitojnë ekonomikisht si rezultat i pagesës për punimet e kryera.

Nëpërmjet investimit synohet dhe të sensibilizohet komuniteti për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të fondit kullimor.

Kapaciteti kullimor aktual dhe ai pas kryerjes së punimeve të planifikuara është si më poshtë:

Nr. Ngast	Sip. (ha.)	KAPACITETI KULLIMOR								
		Ishte			Bëhet			Diferenca (±)		
		Dele	Dhi	Të trasha	Dele	Dhi	Të trasha	Dele	Dhi	Të trasha
6/a	4.3	360	456	51	561	666	84	201	210	33

- **Vlerësimi dhe Monitorimi mjedisor:**

Ndikimet që do të ketë në mjedis, gjatë kryerjes së punimeve të planifikuara për përmirësimin e kullotës në parcelën Nr.6/a ndahen në:

- ndikime gjatë zbatimit të punimeve
- ndikime pas perfundimit të punimeve

Keto ndikime përfshijnë mjedisin ekologjik, fizik si dhe faunen e zones. Ndikimet negative të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut gjatë fazes së zbatimit dhe fazes së operimit janë jetëshkurtër dhe do të zhduken kur projekti të përfundojë. Kështu gjatë kryerjes së punimeve disa nga ndikimet në mjedis do të jenë:

- Punimet për prerjen e shkulljen dëmshe dhe prerjen e shkurreve të dëmshe brenda ngastres kullimore do të sjellin nxitje të erozionit të tokës në një masë të kufizuar.
- Po kështu zhurmat gjatë kryerjes së punimeve janë një tjetër ndikim negativ që do të shkaktohet në mjedis, duke sjelle shqetësime edhe për faunen në afërsi të objektit.
- Djegia e ferrave e drizave, ndikon negativisht në mjedis si dhe në rast pakujdesie mund të rrezikojë përhapjen e zjarrit, prandaj gjatë kryerjes së këtij procesi duhen marrë masat e nevojshme për eliminimin e mundësisë së përhapjes së zjarrit duke i grumbulluar e djegur ato në vende të përshtatshme.

Ndërsa ndikimet pas perfundimit të punimeve në përgjithësi konsiderohen si ndikime pozitive në mjedis sepse:

- Pas perfundimit të punimeve të planifikuara, shkalla e mbulimit me vegjetacion (Bimësi barishtore) të sipërfaqes së pastruar nga gurët dhe shkurret (Ferrat, Fier dhe Xanë) e dëmshe gjatë kryerjes së punimeve do të rritet dhe do të sigurohen përfitime mjedisore, për shkak të rritjes së nivelit të shërbimeve në mjedis që ofron kullota.
- Do të rritet kapaciteti i strehës dhe ushqimit për faunen në objekt.
- Veshja e sipërfaqes me bimësi, do të ndikojë pozitivisht në stabilizimin e tokës
- Do të rritet kapaciteti kullor dhe koeficienti i shfrytëzueshmërisë së kullotës.

Do të kemi një përmirësim të mjedisit ekologjik.

- **Kuotimi për bazën materiale:**

Për realizimin e punimeve të planifikuara nuk janë planifikuar shpenzime blerje për vegla pune e bazë materiale.

- **Analiza e riskut:**

Për arritjen e objektivave të parashikuar mund të paraqiten vështirësi në sigurimin e fuqisë punëtore të nevojshme kryesisht gjatë periudhës së punimeve në kulturat bujqësore, pasi aktiviteti kryesor i banorëve të fshatrave për rreth objektit, është kryesisht bujqësia e blegtoria. Gjithashtu vështirësi paraqet dhe largësia e objektit nga qendrat e banuara, pasi punëtorët duhet të ecin në këmbë 30 min në ditë për vajtjen dhe kthimin nga puna.

Rreziqet që mund të shfaqen, janë zjarret si dhe zgjatja e kohës së pa përshtatshme për kryerjen e punimeve. Për minimizimin e rrezikut të zjarreve, stafi drejtues i shoqatës duhet të punojë vazhdimisht për sensibilizimin e komunitetit duke marrë masa për mbrojtjen e objektit dhe në përgjithësi të fondit pyjor/kullor.